

Njoftim

Sipas rekomandimit të Raportit të Bankës Botërore për të bërit biznes dhe duke u bazuar në parimin e “një zyreje shërbyese” (sipas Ligjit Nr. 04/L-100 për Ndërtim), Drejtoria e Urbanizmit në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, si masë shtesë për shkurtimin e procedurave për pajisje me leje ndërtimore, ka ndryshuar mënyrën e aplikimit për pajisje me pëlqimin përkatës për masat mbrojtëse kundër zjarrit (DHSPMSH) dhe për pajisje me Leje Mjedisore Komunale (DPSZHQ). Dokumentacioni ndërtimor i nevojshëm dhe mënyra e aplikimit, është përshkruar në vijim:

Dokumentacioni ndërtimor për Masat e mbrojtëse nga zjarri të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet nga kjo drejtori në kompetencë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit të Komunës së Prishtinës, për sigurimin e “Deklaratë” për Masat e mbrojtjes nga zjarri.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar;
- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m`, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin-"zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhësë, me kuota relative dhe absolute;
- Kushtet ndërtimore, të caktuara nga Drejtoria e Urbanizmit (kopje);
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të investitorit dhe të hartuesit të planit të mbrojtjes nga zjarri.

Dokumentacioni ndërtimor për Leje Mjedisore Komunale të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3)kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;
- Certifikatën për regjistrimin e biznesit;
- Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit;
- Kontratën për shfrytëzimin e parcelës, nëse parcela nuk është pronë e aplikuesit.

Kjo mënyrë e aplikimit për dokumentet e referuar si më lartë, do të fillojë nga data 08.03.2017